



VENDIM

Data e miratimit: 14.09.2011

Nr. i rastit: 2010-06

Latif Fanaj

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 shtator 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURAT

1. Ankesa është regjistruar më 8 shtator 2010.
2. Më 8 dhjetor 2010, Paneli ka kërkuar nga Shefi i Misionit (ShM) të EULEX-it që t'ia dërgon kopjet e vendimeve të UNMIK-ut rreth ndërprerjes së hetimeve të ndryshme rreth rastit. Këto hetime ishin përmendur në ankesë dhe në dokumentet përcjellëse. Më 24 janar 2011 përgjigja është marrë së bashku me disa nga dokumentet e kërkuara.

3. Më 9 shkurt 2011 Paneli kërkoj nga PSSP i UNMIK-ut që të siguroj kopjet e raportit të hetimit të policisë të përgatitur nga UNMIK-u rreth kësaj çështje. Sipas përgjigjes së datës 22 mars 2011, të gjitha dosjet që lidhen me rastin ishin bartur më 23 dhjetor 2008 nga UNMIK-u në EULEX.
4. Më 29 mars 2011, Sekretariati i Panelit kishte kërkuar leje nga EULEX-i që të hetoj tërë dosjen e rastit. Më 14 prill 2011 ishte dhënë leja. Sekretariati i Panelit ka hetuar dosjen e rastit më 11 maj 2011.
5. Në ndërkohë, më 23 shkurt 2011, Paneli ka vendosur që ta njoftoj ShM lidhur me ankesën, duke e ftuar ShM që të paraqes vërejtjet me shkrim rreth pranueshmërisë dhe bazueshmërisë së ankesës. Gjithashtu ishte vendosur që të shqyrtohej në të njëjtën kohë si bazueshmëria e ankesës ashtu edhe pranueshmëria e saj (Rregulla 30, paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së punës së Panelit, më tutje: RrP).
6. Vërejtjet e ShM ishin marrë më 21 qershor 2011, e pastaj iu ishin dërguar parashtruesit të ankesës për vërejtje shtesë nga ai.
7. Parashtruesi i ankesës nuk iu ishte përgjigjur kërkesës për paraqitjen e vërejtjeve. Ai ishte njoftuar se nëse nuk ofron ndonjë përgjigje deri në datën e caktuar, Paneli mund të vendos rreth kësaj çështje në bazë të informatave në dispozicion.

FAKTET

I. RRETHANAT E RASTIT

8. Siç janë paraqitur nga palët dhe siç duken nga dokumentet në dispozicion të publikut, faktet e rastit mund të përmbliidhen si në vijim.

Parathënie

9. Parashtruesi i ankesës është vëllai i z. Hasan Fanajt, i cili ka vdekur së bashku me z. Ardian Thaqin, z. Mentor Mehmetajn, z. Sinan Demollin, z. Hamëz Hasanin në burgun e Dubravës më 4 dhjetor 2003.

Incidenti në burgun e Dubravës

10. Më 4 shtator 2003, rreth orës 12:30, një numër i të burgosurve në burgun e Dubravës kishin sulmuar rojet e paarmatosur të burgut dhe kishin ngritur pengesa në hyrjen e bllokut të qelisë në mënyrë që t'i pengojnë rojet të hyjnë aty. Pas kësaj, të burgosurit kishin kërkuar, mes të tjerash, përmirësimin e kushteve të jetesës nga drejtorja e burgut, mirëpo nuk ishte arritur asnjë marrëveshje lidhur me këto çështje.

11. Rreth orës 22:45, një ekip për ndërhyrje kishte filluar t'i largoj dyshekët që ishin përdorur nga të burgosurit si pengesa. Të burgosurit i kishin vënë zjarrin këtyre dyshekëve. Pesë të burgosur vdiqën si pasojë e thithjes së tymit toksik dhe plagëve të marra nga zjarri që kishte pasuar.

Hetimi nga prokurori i UNMIK-ut, Njësia Qendrore për Hetimin e Krimeve të UNMIK-ut (NjQHK) dhe policia e UNMIK-ut

12. Më 5 shtator 2003, prokurori i UNMIK-ut kishte kërkuar hetimin dhe autopsinë e trupave të të pesë të burgosurve të vdekur.
13. Më 7 shtator 2003, NjQHK të UNMIK-ut kishte publikuar raportin e vet rreth hetimit paraprak të incidentit.
14. Më 22 shtator 2003, Komponenti i Policisë së UNMIK-ut kishte nisur një hetim penal rreth incidentit të emëruar si: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm përmes zjarrit që janë vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme dhe që ka përfunduar me vrasje.
15. Më 10 gusht 2004, prokurori i UNMIK-ut kishte kërkuar nga hetuesit që të zgjerojnë fushëveprimin e hetimit për të përfshirë sjelljen e mundshme penale apo pakujdesinë penale nga ana e Divizionit të Drejtorisë Penale apo nëpunësve të tjerë të UNMIK-ut. Sidoqoftë, duket se në lidhje me këtë nuk është bërë asgjë.

Hetimi nga Komisioni Dubravës

16. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK-ut (PSSP) ka themeluar Komisionin e Dubravës (më tutje: Komisioni) më 10 shtator 2003 në mënyrë që, ndër të tjerash, të vërtetoj ngjarjet e 4 shtatorit 2003, si dhe faktet dhe rrethanat që çuan deri aty.
17. Komisioni ka shqyrtuar mënyrën se si iu ishte qasur incidentit nga ana e autoriteteve, ankesat e të burgosurit dhe arsyet e incidentit; planin emergjent për trajtimin e trazirave në burg; incidentet e mëparshme në burg; kushtet e të burgosurve, trajnimin e menaxhmentit dhe trajnimin në burg.
18. Komisioni ka përfunduar shqyrtimin e tij më 4 nëntor 2003 me publikimin e një raporti në të cilin kishte bërë tridhjetë e nëntë (39) rekomandime në mënyrë që të vendosen standarde të mira për menaxhimin e burgjeve në këtë burg.

Kërkesat e parashtruesit të ankesës për informata nga Komisioni i Dubravës.

19. Më 19 nëntor 2003, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga Komisioni që të ofroj të gjithë dokumentacionin në lidhje me rastin, së bashku me raportin e Komisionit në gjuhën shqipe. Kjo kërkesë iu ishte drejtuar PSSP-së për një vendim.

20. Më 28 janar 2004, parashtruesit të ankesës iu ishte dhënë një kopje e raportit të Komisionit, mirëpo të gjitha materialet e tjera ishin konsideruar konfidenciale në përputhje me detyrat e punës së Komisionit dhe se atij iu ishte mohuar qasja në te.
21. Më 13 tetor 2004, parashtruesi i ankesës ishte njoftuar se si pasojë e gjetjeve të raportit të Komisionit, ishte duke u kryer një hetim penal nga një prokuror ndërkombëtarë në Pejë.

Kërkesat e parashtruesit të ankesës për informata rreth procedurës

22. Më 14 mars 2005, parashtruesi i ankesës ka kërkuar informata rreth hetimit penal nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut (DDU). Më 6 prill 2005, ai ishte njoftuar se hetimi ende ishte duke u zhvilluar dhe se prokurori ndërkombëtarë ishte duke i shqyrtuar raportet e hetimit të policisë.
23. Më 18 dhjetor 2006, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar informata rreth rastit nga prokurori publik në Pejë. Në shkurt 2007, ai ishte njoftuar se prokurori publik nuk kishte informata rreth incidentit që kishte ndodhur në vitin 2003 në burgun e Dubravës dhe se parashtruesi i ankesës duhet të këshillohej me prokurorin ndërkombëtar, i cili ishte përgjigjes rreth hetimit.
24. Më 16 shkurt 2007, rasti i parashtruesit të ankesës ishte regjistruar tek institucioni i Avokatit të Popullit.
25. Më 30 gusht 2007, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar prapë informata nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut. Ai ishte njoftuar përmes një letre të datës 11 shtator 2007 se gjetjet e hetimit ishin duke u shqyrtuar ende. E njëjta përgjigje u ishte dhënë nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut pas pyetjeve nga Avokati i popullit më 27 shtator 2007.
26. Më 9 tetor 2007, prokurori ndërkombëtar i ngarkuar me rastin kishte propozuar që të takohej me të afërmit e viktimave. Duket se asnjëherë nuk është zhvilluar ndonjë takim i tillë.
27. Më 2 shtator 2008, në një letër dërguar DDU, parashtruesi i ankesës kishte shprehur shqetësim rreth kohëzgjatjes së procedurave. Më 15 tetor 2008, parashtruesi i ankesës ishte këshilluar që të kontaktoj prokurorin ndërkombëtar.
28. Më 28 prill 2010, ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it kishte njoftuar parashtruesin e ankesës se zyra e tij ishte duke marrë hollësi të reja rreth rastit dhe se një takim me parashtruesin e ankesës mund të mbahej kah fundi i majit 2010. Ky takim u mbajt në pjesën e parë të muajit qershor të vitit 2010.

Përgatitja e ndjekjes penale nga prokurorët ndërkombëtarë

29. Më 17 dhjetor 2007, prokurori ndërkombëtar kishte dorëzuar tek gjykatësi i procedurës paraprake në Pejë një vendim për nisjen e një

hetimi ndaj pesëmbëdhjetë të burgosurve që dyshohej se ishin përfshirë në atë incident. Ky vendim u regjistrua më 11 janar 2008 tek gjyqtari i procedurës paraprake.

30. Më 9 qershor 2008, gjykatësi i procedurës paraprake kishte vazhduar afatin për hetim deri më 9 dhjetor 2008. Nuk dihet nëse ky afat kishte vazhduar ose jo në dhjetor 2008.
31. Më 9 dhjetor 2008, EULEX-i kishte marrë përsipër përgjegjësitë nga UNMIK-u për rastet e pazgjidhura ligjore dhe hetimet policore me disa përjashtime. Dokumentacioni lidhur me rastin e parashtruesit të ankesës ishte dorëzuar zyrtarisht tek EULEX-i më 23 dhjetor 2008 (shih paragrafin 3 më lart).
32. Më 16 korrik 2010, prokurori i EULEX-it kishte ndërprerë procedurat kundër të burgosurve në fjalë, pasi ka gjetur se nuk kishte dyshim të arsyeshëm se të pandehurit kishin kryer veprat penale në fjalë.
33. Vendimi ishte bazuar në vlerësimin e intervistave dhe deklaratave të bëra nga dëshmitarët gjatë hetimit të zhvilluar nga prokurorët dhe policët e UNMIK-ut. Gjithsej 98 të burgosur, 19 roje të burgut dhe katër (4) pjesëtarë të personelit ndërkombëtarë ishin intervistuar gjatë fazave të ndryshme të hetimit nga policia dhe prokurori. Prokurori ka vënë re se dëshmitarët nuk e dinin se kush e kishte filluar trazirën apo zjarrin. Disa dëshmitarë të cilët kishin fajësuar disa prej të pandehurve kur ishin duke u intervistuar nga policia, nuk kishin qenë në gjendje që t'i vërtetonin deklaratat e tyre më vonë para prokurorit.
34. Prokurori ka përfunduar se prova e mbledhur gjatë hetimit ka lejuar që të nxirren gjetjet faktike në lidhje me pasojat e trazirës dhe zjarrit, mirëpo nuk ka dhënë asnjë gjetje të hollësishme lidhur me fajësinë individuale të të dyshuarve. Nuk ka pasur tregues të qartë se të dyshuarit kanë vepruar në mënyrë të qëllimshme. Për t'i ngarkuar të dyshuarit me vepër penale, ka qenë e nevojshme që të vërtetohet se ata e kishin parashikuar përfundimin e ngjarjeve. Pasi prova në dispozicion nuk kishte treguar se të dyshuarit kishin vepruar me qëllim kriminal, nuk ishte mundur që ata të akuzoheshin për vepra penale.
35. Parashtruesi i ankesës ishte njoftuar rreth këtij vendimi përmes një letre të datës 16 korrik 2010. Ai kishte mundësi që ose të paraqiste një kërkesë me shkrim për vazhdimin e hetimit tek një gjykatës i procedurës paraprake ose të ngiste padi kundër të akuzuarve pranë Gjykatës së Qarkut brenda tetë (8) ditëve nga marrja e njoftimit për ndërprerjen e hetimit.

II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

36. Nenet 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në

Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), për pjesët e tyre përkatëse thotë si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrihen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndhimë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;

...

(d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;

(e) kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar;

(f) kontribuon në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

...

(i) të siguron që të gjitha veprimtaritë saj zbatojnë standardet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Ligji mbi kompetencat

37. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, më tutje: Ligji mbi kompetencat) dhe më saktësisht nenet 7 dhe 8 të tij, rregullojnë përfshirjen dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Neni 7 Kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të ZPSK-së¹ apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ai apo ajo është e caktuar nga kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

...

¹ ZPSK = Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës

7.4 Prokurorët e EULEX-it do t'i kryejnë funksionet e tyre në përputhje me ligjin në fuqi. Ata do të jenë nën autoritetin ekskluziv të Kryeprokurorit të EULEX-it dhe nuk do t'iu nënshtrohen ndonjë institucioni të Kosovës.

Neni 8 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

8.1 Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të ZPSK-së sipas ligjit mbi themelimin e ZPSK-së, dhe krimet, përfshirë këtu tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3 të nenit 3 të këtij ligji.

Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës

38. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës (RA 2003/26, më tutje: KPPPK), përmes Neneve 221, 224 dhe 225 rregullon punën e prokurorit publik para se rasti të zgjidhet në gjykatë.

Neni 221

(1) Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit publik. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale dhe provat me informacionin e mbledhur deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake.

...

Neni 224

(1) Prokurori publik e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se:

1) Nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale;

...

(2) Prokurori publik brenda tetë ditësh pas pushimit të hetimit e lajmëron të dëmtuarin për këtë fakt dhe arsyen për këtë (neni 62 i këtij Kodi). Prokurori publik pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pushimin e hetimit.

Neni 225

(1) Nëse hetimi nuk përfundon brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, prokurori publik i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake së bashku me arsyet për zgjatjen e hetimit.

(2) Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim të hetimit deri në gjashtë muaj kur kjo arsyetohet me ndërlikueshmërinë e çështjes. Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me të paktën pesë vjet burgim, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë edhe një vazhdim deri në gjashtë muaj. Gjykata Supreme e Kosovës, në raste të veçanta, mund të autorizojë edhe një vazhdim prej gjashtë muajsh.

...

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

A. Ankesat

39. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka shkelje të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

(KEDNj, 1950, më tutje: Konventa) si dhe të Konventës kundër torturës dhe trajtimeve e dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese (KKT, 1984).

40. Parashtruesi i ankesës pretendon se as UNMIK-u e as EULEX-i nuk kishin zhvilluar hetime të duhura rreth incidentit në burgun e Dubravës. Më tutje ai pretendon se nuk është konfirmuar asnjë gjetje rreth personave përgjegjës për vdekjen e djalit të tij dhe katër të burgosurve të tjerë.
41. Nga faktet e rastit kuptohet se parashtruesi i ankesës pretendon se ka shkelje të nenit 2 të KEDNj (e drejta për jetë) dhe në veçanti në detyrimin procedural të Shtetit që të hetoj shkaqet e vdekjeve. Paneli do të shqyrtoj rastin vetëm sipas nenit në fjalë.
42. Dispozita përkatëse e kësaj Konvente thotë si më poshtë:

Neni 2 E drejta për jetë

1. E drejta e çdo njeriu për jetë mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.
2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme;
 - (a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
 - (b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;
 - (c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

B. Dokumentet e dorëzuara nga palët

43. Në dokumentet e dorëzuara, ShM vë në dukje se Paneli nuk ka kompetenca të natyrshme, mirëpo se ai është e obliguar nga OPLAN i EULEX-it (një dokument i cilësuar si *i Kufizuar nga BE*, i cili nuk mund të publikohet) dhe interpretimet e tij të mëvonshme nga ShM.
44. ShM është i mendimit se vendimet e prokurorëve të EULEX-it janë pjesë e procedurave gjyqësore, të cilat nuk hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit, siç paraqitet në RrP të Panelit, Rregullorja 25, paragrafi 1.
45. Për më tepër, ShM ka deklaruar se Paneli nuk është nivel shtesë për shqyrtim gjyqësor dhe çfarëdo vendimi i marrë nga prokurorët e EULEX-it apo prokurorët e Kosovës mund të apelohej përmes rrugëve ligjore të vendit. Në këtë rast, një rrugë e tillë do të ishte që parashtruesit e ankesës të paraqitnin një njoftim për të vazhduar me ndjekje penale ndihmëse.
46. ShM thekson se ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut është drejtpërsëdrejti i zbatueshëm në Kosovë dhe mund të shfrytëzohet që të apelohej vendimet e lëshuara nga autoritetet publike pranë Gjykatës Kushtetuese, përmes një ankese kushtetuese.

47. Së fundi, ShM i referohet vendimit të Panelit në rastin e *Cyma Agovic kundër EULEX-it* (2010-16, Vendim i datës 7 dhjetor 2010) në të cilën Paneli ka gjetur se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ajo kishte të bëjë me procedura ligjore të kryera nga gjykatat e Kosovës. ShM argumenton se e njëjta qasje zbatohet në këtë ankesë *me ndryshimet e nevojshme*.
48. ShM përfundon se kjo ankesë është e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme. Në secilin rast, standardi i detyrës që kërkohet nga një shtet palë lidhur me kryerjen e një hetimi efikas kur ndodhin vdekje në rrethana të dyshimta nuk është shkëlur në atë mënyrë që do t'i atribuohet stafit të EULEX-it apo agjentëve të tij.

C. Komente të përgjithshme rreth pranueshmërisë

Kushtet e përgjithshme të procedurës së pranueshmërisë

49. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës nga prokurori i EULEX-it (RrP).

Zbatimi i kërkesës gjashtë mujore

50. Ankesa ishte regjistruar më 8 shtator 2010, pra tre muaj nga data kur Paneli mund t'i pranoj ankesat (8 qershor 2010) dhe gjithashtu brenda gjashtë muajve nga vendimi i marrë rreth rastit nga prokurori i EULEX-it (16 korrik 2010).

Mos kthimi i përgjigjes nga parashtruesi i ankesës

51. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës nuk iu ishte përgjigjur vërejtjeve të ShM. Paneli konsideron se shqyrtimi i duhur i ankesës, nga pikëvështrimi i Nenit 6 të Konventës, normalisht do të kërkonte që argumentet e të dy palëve të dorëzoheshin për një procedurë kundërshtuese.
52. Sidoqoftë, Paneli mendon se respektimi i të drejtave të njeriut bën të nevojshme që të shqyrtimi i këtij rasti të vazhdoj; aq më tepër pasi kjo ankesë në thelb është e njëjtë dhe ka të bëjë me fakte të njëjta ashtu siç janë paraqitur nga të katër parashtruesit e tjerë të ankesës që gjithashtu ngritin çështje të njëjta ligjore.

Kompetenca e Panelit lidhur me vendimet e prokurorëve të EULEX-it

53. Paneli mund që të shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushat e drejtësisë, policisë dhe doganave, ashtu siç është paraqitur në Rregullin 25, paragrafi 1 i RrP.
54. Sipas Rregullës në fjalë, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave në Kosovë.

55. Procedurat gjyqësore ku zbatohen garancitë që dalin nga Neni 6 i Konventës duhet të kuptohen si ato që kryhen nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm brenda kuptimit të kësaj dispozite.
56. Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se kompetencat e prokurorëve të EULEX-it janë kryesisht të përcaktuara në “Ligjin mbi kompetencat”, si dhe në “Ligjin për Zyrën e Prokurorisë Speciale (ZPSK).
57. Prokurorët e EULEX-it, përveç kryerjes së veprimtarive të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit në Mision e EULEX-it për zbatimin e ligjit në Kosovë, i ushtrojnë edhe kompetencat ekzekutive përmes kryerjes së hetimeve penale dhe përmes ndjekjes penale të rasteve të reja dhe të pazgjidhura, siç saktësohet në Nenet 7 dhe 8 të Ligjit mbi Kompetencat (shih paragrafin 37 më lart).
58. Për më tepër, sipas KPPK, Neni 221, një hetim penal duhet të iniciohet nga një vendim i prokurorit publik. Periudha prej gjashtë (6) muajve për hetime fillon nga data e këtij vendimi. Vendimi i përmendur është dërguar tek gjykatësi i procedurës paraprake, i cili, në përputhje me Nenin 225 të KPPK ka të drejtë të autorizoj vazhdimin e asaj periudhe, nëse kërkohet nga prokurori. Personat nën hetime nuk janë të paditur, e as nuk janë detyrimisht të njoftuar për një hetim të tillë.
59. Pas përfundimit të hetimit, prokurori vendosi nëse do të vazhdojë procedurën duke ngritur aktakuzë në gjykatën e shkallës së parë apo ndërprerjen e hetimit.
60. Paneli nënvizon se në shumë raste Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mposhtëm “Gjykata”) ka konsideruar se një prokuror publik nuk mund të konsiderohet si një zyrtar që ushtron “pushtetin gjyqësor” brenda kuptimit të nenit 5 § 3 të Konventës (shih *Merit kundër Ukrainës*, nr. 66561/01, §§ 62-63, 30 mars 2004; *Nevmerzhitsky kundër Ukrainës*, nr. 54825/00, § 125, KEDNj 2005-II (shtojcat); *Niedabala kundër Polonisë*, nr. 27915/95, § 53, 4 korrik 2000). Aq më pak që një prokuror publik mund të konsiderohet se është i veshur me attribute gjyqësore të “pavarura” dhe “të paanshme” (shih *Schiesser kundër Zvicrës*, vendimi i 4 dhjetorit 1979, Seria A nr. 34, pp. 12-17, §§ 27-41).
61. Siç ka nënvizuar Gjykata, kornizës ligjore brenda së cilës janë bërë ndërhyrjet e prokurorëve publik iu mungojnë garancionet e procedurës gjyqësore (siç është, ndër të tjerash, pjesëmarrja e personave në fjalë, mbajtja e seancave, publiciteti, karakteri kundërshtues, qasja e barabartë e palëve etj.). Prokurorët marrin vendime me nismën e tyre dhe gëzojnë liri të konsiderueshme për të përcaktuar se çfarë kursi të veprimit do ta ndjekin, mirëpo ata normalisht sipas hierarkisë janë në varësi nga një prokuror më i lartë.
62. Vetëm fakti se ankesat mund të bëhen kundër vendimeve të prokurorëve tek një prokuror në hierarki më të lartë, nuk mund as të

bëjë kompensimin për shkak të mungesës së garancioneve gjyqësore e as të identifikohet me garancionet e tilla. Për më tej, fakti se prokurorët veprojnë si kujdestarë të interesit publik nuk mund të konsiderohet se atyre iu jepet një status juridik i aktorëve të pavarur dhe të paanshëm (shih *Zlínstat, spol. s.r.o., kundër Bullgarisë*, nr. 57785/00, § 78, 15 qershor 2006).

63. Paneli vëren se asnjë argument nuk u është dorëzuar për rastin në fjalë për të treguar se pozicioni institucional dhe procedural i prokurorëve të EULEX-it është i tillë që t'i japin atyre një status të pavarur juridik, i ngjashëm me atë që gëzojnë gjykatat.
64. Prandaj veprimet apo mos veprimet nga prokurorët gjatë fazës hetuese të procedurave penale nuk mund të konsiderohen se janë bërë në kontest të "procedurave gjyqësore".
65. **Për këto arsye Paneli konsideron se veprimet e prokurorit të EULEX-it të marra gjatë shqyrtimit të një rasti janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të Panelit përderisa nuk është ngritur ndonjë aktakuzë pranë një gjykate, kompetente për t'i shqyrtuar meritat e rastit.**

Neni 2 i Konventës - parimet e përgjithshme në praktikën gjyqësore të KEDNj

66. Neni 2 i Konventës është njëra prej dispozitave më themelore. Synimi apo qëllimi i kësaj Konvente si një instrument për mbrojtjen e qenieve njerëzore bën të nevojshme që Neni 2 të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që masat mbrojtëse të saj të jenë praktike edhe efektive (shih, midis autoriteteve të tjera, *Anguelova kundër Bullgarisë*, nr. 38361/97, § 109, KEDNj 2002-IV).
67. Fjalja e parë e nenit 2 § 1 e detyron Shtetin jo vetëm që të përmbahet nga marrja e qëllimshme dhe joligjore e jetës, mirëpo edhe të marrë hapat e duhura për të mbrojtur jetën e atyre brenda kompetencave të tij (shih *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, § 36, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998-III; *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, § 115, Raportet 1998-VIII; dhe *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, § 71, KEDNj 2002-II).
68. Megjithatë, detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën duhet të interpretohet në atë mënyrë që mos të imponohet një barrë e tepërt mbi autoritetet, në veçanti duke marrë parasysh paparashikueshmërinë e sjelljeve njerëzore dhe zgjedhjeve operative të cilat duhet të bëhen sipas prioriteteve dhe burimeve (shih, midis autoriteteve të tjera, *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, § 90, KEDNj 2001-III, dhe *A. dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 30015/96, §§ 44-45, 27 korrik 2004).
69. Duke pasur parasysh karakterin e tij themelor, Neni 2 i kësaj Konvente imponon edhe një detyrim procedural në autoritetet që të

kryejnë një hetim efektiv rreth shkeljeve të dyshuara të pjesëve thelbësore të këtyre dispozitave (shih, midis autoriteteve të tjera, Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë [GC], nr. 23458/02, § 298, 24 mars 2011).

70. Neni 2 nuk ka të bëjë vetëm me vdekjet që pasojnë nga përdorimi i forcës nga agjentët e Shtetit. Detyrimet procedurale të cekura më lart bëjnë thirrje për një sistem gjyqësor efektiv, e cila mund të përcaktojë shkakun e vdekjes dhe që të japin llogari personat përgjegjës (shih *Calvelli dhe Ciglio kundër Italisë* [GC], nr. 32967/96, § 49, KEDNj 2002-I; *Vo kundër Francës* [GC], nr. 53924/00, § 89, KEDNj 2004-VIII; dhe *Šilih kundër Sllovenisë* [GC], nr. 71463/01, § 192, 9 prill 2009; *Rajkowska kundër Polonisë* (vendim), nr. 37393/02, 27 nëntor 2007). Për këtë arsye autoritetet duhet të sigurojnë me të gjitha mjetet në dispozicionin e tyre një përgjigje të përshtatshme - gjyqësore apo ndryshe - kështu që korniza legjislative dhe administrative e krijuar për mbrojtjen e të drejtës për jetë të zbatohet në mënyrë të duhur dhe se çdo shkelje e kësaj të drejte të pengohet dhe dënohet (shih *Zavoloka kundër Latvisë*, nr. 58447/00, § 34, 7 korrik 2009).
71. Autoritetet duhet të marrin çfarëdo hapi të arsyeshëm që mundën për të siguruar provat lidhur me incidentin, *ndër të tjerash*, dëshmitë nga dëshmitarët okular dhe dëshmitë mjeko-ligjore. Në veçanti, përfundimet e hetimit duhet të bazohen në analiza të plota, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve përkatëse. Megjithatë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit e cila e përmbush kufirin minimal të efektshmërisë së hetimit varet nga rrethanat e atij rasti. Ato duhet të vlerësohen në bazë të të gjitha fakteve përkatëse dhe lidhur me realitetin praktik të punës hetimore (shih *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, § 105, 1 dhjetor 2009).

Kompetenca të përkohshme

72. Në pajtim me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht nenin 28 të Konventës së Vjenës mbi të Drejtat e Traktateve, dispozitat e ndonjë konvente nuk e detyrojnë Palën Kontraktuese në lidhje me ndonjë akt apo fakt që ka ndodhur apo ndonjë situatë e cila ka pushuar së ekzistuari para datës së hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me atë Palë (shih KEDNj, *Blečić kundër Kracisë* [GC], § 70; *Šilih, të cituar më lart*, § 140; *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], § 130).
73. Sipas Rregullores 25, paragrafi 2 i RrP, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008 në Kosovë.
74. **Prandaj, kompetencat e përkohshme të Panelit mbulojnë vetëm periudhën pas datës 9 dhjetor 2009 kur EULEX-i u bë operativ.**
75. Megjithatë, Paneli mund të ketë parasysh faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, për shkak të lidhjes së tyre shkakore me faktet që pasojnë të cilat krijojnë bazën e vetme të ankesës të dorëzuar tek Paneli (shih, *me ndryshimet e nevojshme*, *Šilih*, cituar më lart, § 141).

76. Në lidhje me këtë, Gjykata ka vërejtur se detyrimet procedurale për të kryer një hetim efektiv sipas Nenit 2 përbën një detyrë të ndarë dhe autonome. Prandaj ajo mund të konsiderohet një detyrim i pavarur që del nga Neni 2, që ka aftësi për të detyruar autoritetet madje edhe kur vdekja ka ndodhur para datës kritike (shih, *ndër të tjerash, Šilih, § 159; Varnava dhe të tjerët, § 147; dhe Velcea dhe Mazare, § 81, të gjithë të cituar më lart*). Detyrimi procedural sipas Nenit 2 obligon autoritetet publike gjatë gjithë periudhës kur në mënyrë të arsyeshme pritet që ata të marrin masa me qëllim që të sqarohen rrethanat e vdekjes dhe të vërtetohen përgjegjësitë për të (shih *Šilih, të cituar më lart, § 157*).
77. Për më tepër, duhet të ketë një lidhje të vërtetë midis vdekjes dhe datës që shënon fillimin e kompetencave të Panelit në mënyrë që të zbatohen detyrimet procedurale të vendosura sipas Nenit 2. Në praktikë, kjo do të thotë se një pjesë e rëndësishme e hapave procedurale të kërkuara nga kjo dispozitë kanë qenë apo duhet të ishin kryer pas datës kritike (gjithashtu shih *Velcea dhe Mazare, të cituara më lart, §§ 83-85; Tuna kundër Turqisë, nr. 22339/03, §§ 58-60, 19 janar 2010; Çakir kundër Qipros (vendimi), nr. 7864, 29 prill 2010*).
78. **Për këtë arsye, në mënyrë që Paneli të ketë kompetenca të përkohshme në një rast ku vdekjet kishin ndodhur para datës kritike të 9 dhjetorit 2008, duhet të vërtetohet se një pjesë e madhe e hapave procedurale sipas Nenit 2 të Konventës ishin apo duhej të ishin ndërmarrë, pas themelimit të EULEX-it, nga EULEX-i.**

D. Vlerësimi i ankesës nga Paneli

Ankesat lidhur me veprimet ose mos veprimet nga UNMIK-ut

79. Ankesa ka fillin në një incident që ka ndodhur në burgun e Dubravës nën administrimin e UNMIK-ut në vitin 2003. Hetimi rreth shkakut të incidentit kishte përfunduar në kohë dhe se Komisioni kishte publikuar raportin e vet më 4 nëntor 2003 (shih paragrafin 18 më lart).
80. Duke marrë parasysh Rregullin 25 të RrP, e cila e kufizon mandatin e Panelit në ankesat që lidhen me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i në Kosovë, Paneli vëren se i mungon kompetenca për të shqyrtuar veprimet apo jo veprimet e ndërmarrura nga UNMIK-u. Prandaj nuk i takon Panelit që të bëjë ndonjë vlerësim ligjor detyrues.
81. Megjithatë, Paneli vëren se së pari Komisioni ka vërtetuar faktet në raportin e vet lidhur me këtë incident. Komisioni ka vënë në dukje disa mangësi në menaxhimin e burgut, kushtet e të burgosurve, procedurat operative të burgut dhe trajnimin e personelit të burgut. Si rrjedhojë, Komisioni kishte bërë tridhjetë e nëntë (39) rekomandime

lidhur me sigurimin në burg, kushtet e të burgosurve, trajnimin e personelit si dhe marrëdhëniet e menaxhimit të UNMIK-ut posaçërisht me personelit vendor dhe agjencitë e tjera (shih paragrafët 17 dhe 18 më lart).

82. Së dyti, Paneli thekson në këtë kontekst se prokurori i UNMIK-ut ka rekomanduar që fusha e hetimit duhet të zgjerohet që t'i mbulojë edhe shkeljet e mundshme apo pakujdesinë penale nga ana e personelit të burgut (shih paragrafin 15 më lart). Sidoqoftë, ky rekomandim nuk ishte përfillur dhe më pastaj asnjë hetim përkatës nuk kishte filluar. Paneli konstaton se kjo është për të ardhur keq.
83. **Megjithatë, për aq sa mund të kuptohet se kjo ankesë ka të bëjë me veprimet apo mos veprimet e ndërmarra nga UNMIK-u, ndërsa duke marrë parasysh kufizimet në fushëveprimin e kompetencave të tij, Paneli shpall ankesën të papranueshme.**

Ankesat në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të autoriteteve të burgut

84. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës, në thelb, pretendon se autoritetet e EULEX-it nuk i kishin kryer detyrat e tyre që dalin nga pjesa procedurale e Nenit 2 të Konventës, e cila kërkon nga ta që të zhvillojnë një hetim të përshtatshëm dhe efektiv rreth vdekjes së djalit të tij. Kërkesa procedurale nuk ka të bëjë me mos zhvillimin e hetimit apo të ndonjë procedure tjetër të mëvonshme ligjore, mirëpo ka të bëjë me dyshimin e mos zhvillimit të asnjë hetimi rreth përgjegjësisë së autoriteteve të burgut për vdekjen e vëllait të tij.
85. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se në dhjetor 2008 atëherë kur EULEX-i mori përgjegjësitë nga UNMIK-u kishin kaluar përafërsisht pesë (5) vite që nga incidenti. Procedurat në pritje të nisura nga UNMIK-u dhe më pastaj të marra nga EULEX-i kanë pasur të bëjnë vetëm me hetimin sa i përket shkeljeve të ndryshme penale të kryera nga të burgosurit. Asnjëherë nuk ishte zhvilluar ndonjë hetim, përtej raportit të Komisionit të përmendur më lart, në lidhje me përgjegjësinë e mundshme penale rreth pjesës së personave që veprojnë në cilësinë e autoriteteve të burgut.
86. Për tu shqyrtuar veprimet dhe/apo mos veprimet e EULEX-it sipas kërkesës së detyrimeve procedurale që dalin nga Neni 2 i Konventës, duhet të ketë një lidhje të vazhdueshme midis vdekjeve që kanë ndodhur në vitin 2003, hetimit që ka pasuar dhe kohës kur EULEX-i ka marrë përgjegjësitë për këtë çështje në vitin 2008.
87. Për më tepër, duhet të vërtetohet se një pjesë e konsiderueshme e hapave procedurale ishte apo duhej të ishte kryer pasi EULEX-i kishte marrë përgjegjësinë për hetim (shih paragrafët 74-77 më lart).
88. Siç paraqitet, nuk është treguar e as pretenduar se EULEX-i ka kryer ndonjë hetim në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve të burgut në këtë incident.

89. Në mungesë të ndonjë hetimi nga UNMIK-u lidhur me përgjegjësinë e mundshme penale sa i përket pjesës së autoriteteve të burgut në lidhje me ngjarjet në fjalë dhe duke pasur parasysh fushëveprimin e përkohshëm të kompetencave të Panelit, nuk mund të thuhet se ekziston një lidhje e vazhdueshme, ashtu siç përmendet në paragrafin 76, e cila sipas nenit 2 të Konventës do ta detyronte EULEX-in që të fillonte tani një hetim në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve për ngjarjen në fjalë.
90. Në secilin rast, kjo gjetje është e ndërlidhur ngushtë me gjetjen e bërë më lart ashtu që EULEX-i nuk ka mandat për të shqyrtuar veprimet apo mos veprimet e UNMIK-ut lidhur me shkeljet e dyshuara të standardeve të të drejtave të njeriut.
91. **Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës nuk përputhet me kushtet e kompetencave dhe e konsideron të papranueshme.**

Ankesat lidhur me ndjekjen penale të të burgosurve

92. Vendimi për të zhvilluar një hetim kundër pesëmbëdhjetë të burgosurve ishte paraqitur tek një gjykatës i procedurës paraprake më 17 dhjetor 2007 (shih paragrafin 29, më lart) nga një prokuror i UNMIK-ut. EULEX-i kishte marrë përgjegjësinë nga UNMIK-u për të vazhduar hetimin e 15 të burgosurve në dhjetor 2008.
93. Prokurori i EULEX-it i cili ishte caktuar rreth rastit kishte ndërprerë hetimin në korrik 2010 me arsyetim se nuk ka pasur dyshim të arsyeshëm rreth të dyshuarve.
94. Paneli tashmë ka gjetur se veprimet dhe mos veprimet e prokurorëve të EULEX-it që kanë ndodhur pas 8 dhjetorit 2008, në veçanti në mungesë të ndonjë procedure gjyqësor pasuese lidhur me faktet e njëjta, para ngritjes së aktakuzës, hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it (shih paragrafin 64 më lart).
95. **Prandaj, Paneli gjen se kjo pjesë e kësaj ankese sa i përket ndjekjes penale të të burgosurve është e pranueshme bazuar në Rregullores 29 të Rregullores së Punës.**
96. Sa i përket përmbajtjes së kësaj pjese të ankesës, parashtuesi i ankesës në thelb ka paraqitur se autoritetet e prokurorisë së EULEX-it nuk kishin kryer detyrat e tyre që dalin nga pjesa procedurale e Nenit 2 të Konventës, e cila iu kërkonte atyre që të kryenin një hetim të duhur dhe efektiv rreth shkakut të vdekjes së vëllait të tij, për aq sa mund të supozohej se ishte shkaktuar nga veprimet e të burgosurve të tjerë.
97. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se hetimi lidhur me përgjegjësinë penale të të burgosurve sa i përket trazirës së vitit 2003 ishte përgjegjësi e Policisë së UNMIK-ut dhe më vonë e prokurorisë së UNMIK-ut. Paneli është i mendimit se ky hetim ishte mjaft i plotë dhe gjithëpërfshirës dhe konkluzionet e dhëna janë regjistruar në mënyrë të hollësishme. Hetimi ka përfshirë mbledhjen e deklaratave të

dëshmitarëve duke përfshirë të burgosurit, rojet e burgut dhe personeli ndërkombëtarë si dhe mbledhjen e dëshmimeve teknike.

98. Më pas, një prokuror i EULEX-it mori përgjegjësinë për këtë rast në dhjetor 2008. Pas një hetimi të dosjes së lëndës dhe një vlerësimi të dëshmisë së mbledhur nga hetimet e UNMIK-ut, prokurori i EULEX-it vendosi të ndërpres hetimin.
99. Paneli konstaton se vendimi i prokurorit, siç përmbledhet në paragrafët 32-34 më lart, bazuar në materialin ekzistues hetimor të grumbulluar nga autoritetet e UNMIK-ut, tregon se ka pasur përpjekje të vërtetë për të vërtetuar faktet përkatëse dhe për të identifikuar personat nga radhët e të burgosurve përgjegjës për vdekjet e pesë të burgosurve.
100. Në veçanti, prokurori ka analizuar provat e dhëna nga 98 të burgosur, 19 roje të burgut dhe katër (4) pjesëtarë nga personeli ndërkombëtarët cilët janë dëgjuar gjatë fazave të ndryshme hetimore nga policia dhe prokuroria.
101. Për më tepër, palët e dëmtuara, përfshirë familjet e personave të vdekur, kishin mundësinë për të vazhduar ndjekjen penale (shih më lart, paragrafi 35). Për sa ka njohuri Paneli, parashtruesit e ankesës nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Në çfarëdo rasti, këto procedura do të merreshin vetëm me të burgosurit, e jo me autoritetet e burgut.
102. **Prandaj, Paneli gjen se EULEX-i kishte kryer përgjegjësitë e veta lidhur me këtë hetim. Si rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës lidhur me këtë.**

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

- *Shpall* se nuk ka kompetencë sipas Rregullit 25 të Rregullores së Punës për të shqyrtuar ankesat në lidhje me veprimet apo jo veprimet e UNMIK-ut, dhe shpall ato të **papranueshme**;
- Shpall **të papranueshme** ankesat sipas Nenit 2 të Konventës, sa i përket veprimeve apo mos veprimeve të EULEX-it në lidhje me hetimin e sjelljes së autoriteteve të burgut;
- *Shpall* ankesat sipas Nenit 2 të Konventës, sa i përket veprimeve të EULEX-it në hetimin që lidhet me përgjegjësinë penale të të burgosurve **të pranueshme**, dhe
- *Konstaton* se sa i përket kësaj **nuk ka pasur shkelje** të Nenit 2 të Konventës nga ana e EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio Balsamo
Kryesues i Panelit